

Fillimi > -Kronikë

Vrasja e 58-vjeçarit në Shkodër, shoqërohet 25-vjeçari që shpëtoi atentatit pak ditë më parë. Djali i viktimës u akuzua si autor

05 Shtator, 2022 12:09



Madhësia e tekstit: - +

SHKODËR

Policia e Shkodrës vijon hetimet intensive për zbardhjen e vrasjes së 58-vjeçarit Ismet Çekorja pasditen e djeshme në lagjen “Kiras”, pak metra larg banesës së tij.

Në kuadër të këtyre hetimeve, policia ka shoqëruar dhe 25-vjeçarin Alban Bruçi, pasi djali i viktimës dyshohet si një nga autorët e atentatit ndaj tij më 25 gusht. Bruçi është marrë në pyetje dhe më pas është lënë i lirë.

Ismet Çekorja, i vrarë dje në Shkodër në një atentat me armë zjarri ishte babai i Bajram Çekores, i dyshuar si autor i atentatit ndaj shtetasit Alban Bruçi mbrëmjen e 25 gushtit. Pak ditë para se të vritej, Çekorja foli për mediat duke mbrojtur djalin e tij dhe mohuar akuzat se ishte i përfshirë në atentatin ndaj Bruçit.

Çekorja u shpreh se djali i tij mbrëmjen e 25 gushtit në orën kur ka ndodhur atentati ndodhej në një mjedis të monitoruar nga kamerat e sigurisë gjë e cila hedh poshtë sipas tij akuzat e policisë.

Ismet Çekorja deklaroi se prej tri vitesh policia e Shkodrës i është vënë në shpinë djali dhe familjes së tij pasi për çdo ngjarje kriminale banesa e tyre rrethohet nga policia.

“Policia ka ardhur në banesën tonë pas vrasjes së Arjan Ferracakut një kohë që viktima ishte nipi im po ashtu kur u vra edhe Fatos Ferracaku prapë më kanë thirrur mua dhe djalin. Pastaj janë vrarë vëllezërit Bilali dhe sërish policia në banesën time një kohë që kemi kaq shumë vite që jemi fqinj. U plagos Admir Bajri, prapë në banesën time dhe familja jonë e ka pasur një lloj njohje me familjen e tyre. Po ashtu u qëllua shefi i policisë bashkiake të Malësisë së Madhe sërish në banesën time kur në fakt autorët dolën krejt persona të tjerë. Rasti i fundit është me Alban Bruçin, djalin e Lad Bruçit të cilin unë e kam shumë mik dhe nuk ka asnjë shans që djali im të qëllojë djalin e tij kur ne kemi shumë miqësi aq më tepër që Bajrami, djali im është i monitoruar me kamera. Këto sulme ndaj familjes tonë i bëjnë disa banditë, hajdutë biçikletash dhe banditë të veshur me pushtet. Se cila është arsyeja ne nuk e dimë. Ajo që kërkojmë është drejtësia. Djali im është i pafajshëm dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë prej ngjarjeve kriminale për të cilat është i dyshuar. Janë të gjithë inskenime dhe tani ai duhet të qëndrojë rrugash dhe nuk mundet as të punojë as asgjë. Kërkojmë drejtësi dhe të zbardhen ngjarjet”, u shpreh Ismet Çekorja.

Alban Bruçi u qëllua me 19 plumba më 25 gusht në Shkodër por arriti që të shpëtojë pa u plagosur. 25-vjeçari shkoi vetë në polici dhe bëri një kallëzim për këtë atentat për të cilin policia shpalli në kërkim shtetasin Bajram Çekorja dhe një person tjetër. Babai i Çekores mohoi akuzat duke thënë se djali i tij nuk është autor në këtë krim dhe asnjë prej ngjarjeve të tjera kriminale.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Alban Bruçi Ismet Çekorja Shkoder vrasja

TË NGJASHME

Vrasja që tronditi Tiranën, dalin panjet e sherrit mes vëllezërve Muskurti (Foto)
04 Shtator, 2022

U vra ditën e djeshme në Shkodër, policia shoqëron 15 persona për eliminimin e Ismet Çekores, çfarë rezultoi
05 Shtator, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Shqiptari dhe një grek u dogjën pas shpërthimit të fortë në fabrikën e peshkut në Greqi, arrestohen dy drejtues (FOTO)
04 Shtator, 2022



Rezultonte i zhdukur prej dy ditësh, gjendet i vrarë biznesmeni shqiptar në Itali (EMRI)
04 Shtator, 2022

Trupi iu gjet i ndarë në dy pjesë, ja kush është 39-vjeçari që vdiq pas shpërthimit në një fabrikë peshku në Greqi, baba i tre fëmijëve (EMRI)
04 Shtator, 2022

Shqiptari godet me sëpatë 27-vjeçaren ukrainase, qëillohet për vdekje nga policia gjermane(Detaje)
04 Shtator, 2022

Shpërthim i fuqishëm në një fabrikë peshku në Greqi, dy viktima dhe një i plagosur
04 Shtator, 2022

Shkrimi në median britanike/ Aktivistët paralajmërojnë Britania po bëhet "Alkatraz i Shqipërisë". Ish-deputeti: Për qeverinë shqiptare e gjithë kjo...

04 Shtator, 2022

KATEGORIA VIDEO



VIDEO/ Gol ndaj Arsenalit që në debutim, blerja e bujshme e Manchester United "con peshë" tifozët në pjesën e parë
04 Shtator, 2022

Përfundon dita e tretë e aksionit të paligjshëm, fadromat e IKMT-së largohen nga "Prestige Resort" (VIDEO)
04 Shtator, 2022

"Veprime të kalkuluara", eksperti i sigurisë për aksionin e IKMT në "Prestige Resort": Është vënë në rrezik siguria e turistëve
04 Shtator, 2022

Aksioni i IKMT në Prestige Resort/ "Situatë jo normale", Bashkim Hoxha: Tregon realitetin tonë, është demonstrim jo zgjidhje problemi
04 Shtator, 2022

"FNSh-ja gati, këtë mjetin para"/ Kontrollë të befasishme, policia ndalon makinat luksoze, arrestohet 38-vjeçari me 3 mbiemra, dhjetëra të tjerë të shoqëruar (Video)
04 Shtator, 2022

Skandal i/ Shkatërrimi te "Prestige Resort", shihni se si mjetet e IKMT rrezikojnë jetën e turistëve (Video)
04 Shtator, 2022

